



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
UNIVERSITETI I TIRANËS  
BORDI I ADMINISTRIMIT

Nr. 2053/prot  
5

Tiranë më 30.11.2022

VENDIM

Nr. 63, Datë 25.11.2022

PËR

**“RIORGANIZIMIN E PROGRAMIT TË CIKLIT TË PARË TË STUDIMEVE BACHELOR NË  
“ARKEOLOGJI DHE TRASHËGIMI KULTURORE”, NË FAKULTETIN E HISTORISË DHE TË  
FILOLOGJISË, TË UNIVERSITETIT TË TIRANËS, PËR VITIN AKADEMIK 2023-2024”**

Në mbështetje të ligjit nr. 80/2015, datë 22.07.2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”, neni 35 pika 1), nenit 73, pika 1), Statutit të Universitetit të Tiranës miratuar nga MASR – ja, me urdhërin nr. 816 datë 26.12.2018, nenit 55, pika 1, shkronja a) udhëzimit nr. 1, datë 14.01.2020 i Ministrisë së Arsimit, Sportit dhe Rinisë “Për dokumentacionin dhe procedurat për hapjen, riorganizimin dhe mbylljen e institucionit të arsimit të lartë, degëve të tyre, njësive kryesore dhe programeve të studimit, si dhe për ndarjen ose bashkimin e institucionit të arsimit të lartë”, kreu IV, shkronja b), i ndryshuar “hapja, riorganizimi dhe mbyllja e programeve të studimit”, vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 41, datë 24.01.2018 “Për elementët e programeve të studimit të ofruara nga institucionet e arsimit të lartë” i ndryshuar, pika 2.9, shkronja c), si dhe vendimit nr. 30, datë 23.11.2022 të Senatit Akademik të Universitetit të Tiranës “Për riorganizimin e programit të ciklit të parë të studimeve Bachelor në “Arkeologji dhe Trashëgimi Kulturorë”, në Fakultetin e Historisë dhe të Filologjisë, të UT-së, për vitin akademik 2023-2024”. Bordi i Administrimit,

VENDOSI:

- Të miratojë riorganizimin e programit të ciklit të parë të studimeve Bachelor në “Arkeologji dhe Trashëgimi Kulturorë”, në Fakultetin e Historisë dhe të Filologjisë të Universitetit të Tiranës, për vitin akademik 2023-2024,
- Burimi i financimit për këtë program studimi do të jetë tarifa e shkollimit për program dhe pa efekte financiare shtesë nga buxheti i UT-së,
- Ky vendimi i përcillet Rektorit, Administratorit të Universitetit të Tiranës dhe Fakultetit të Historisë dhe të Filologjisë; UT-së,

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

